



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, Vendimit të Kuvendit të Komunës për furnizimin e përkohshëm me derivate të automjeteve të njësisë operative KRM "Pastrimi" në Lipjan Nr.15-352/01-27010 i datës 29.05.2025 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M PËR CAKTIMIN E MENAXHERIT MBIKQYRËS

Neni 1

Me këtë Vendim, **Rrahim Krasniqi**, Udhëheqës i Sektorit për Mirëmbajtje dhe Sigurim të objekteve **CAKTOHET** si **Menaxher mbikqyrës** i zbatimit të dispozitave të Vendimit të Kuvendit të Komunës për furnizim të përkohshëm me derivate të automjeteve të njësisë operative" KRM Pastrimi" në Lipjan Nr.15-352/01-27010 i datës 29.05.2025.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Zyrtari përgjegjës Rrahim Krasniqi.

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet Vendimi për furnizim të përkohshëm me derivate për automjetet e "KRM Pastrimi" në Lipjan 1Nr.352/01-24758 i datës 20.05.2025.

1Nr. 112/02-30032
Lipjan, më 18.06.2025

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 par. 4 dhe 5 i Rregullores MF -Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore ,nenit 72A të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik (vendim i konsoliduar), neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR PRANIMIN E PASURISË JO FINANCIARE –TË KOMUNËS

Neni 1

Përbërja e Komisionit

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për pranimin e pasurisë jofinanciare të Komunës duke përjashtuar Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare-QKMF-në, Shtëpinë e Komunitetit për persona me aftësi të kufizuara mendore- ngecje në zhvillim mendor, Shkollat dhe Çerdhen publike , në këtë përbërje:

1. Adelina Rexhepi, Kryesuese
2. Shefki Sadiku, anëtar
3. Arbëresha Hetemi, anëtare
4. Menaxheri/a i kontratës

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni në pajtim me dispozitat e Rregullores MF -Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore dhe Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik (vendim i konsoliduar) bën pranimin e pasurisë jofinanciare përkatësisht furnizimeve, shërbimeve dhe punëve për vitin 2025 dhe gjatë pranimit ka për detyrë si vijon :

1. Të verifikojë sasinë e porositur, cilësinë, llojin dhe vlerën e pasurisë jofinanciare në përputhshmëri me kontratën për urdhërblertjen.
2. Komisioni nuk duhet të pranojë pasurinë jofinanciare e cila nuk është në përputhje me kontratën dhe urdhërblertjen (mënyra e amabalazhimit, cilësisë llojllojshmërisë, plotësisë dhe marka e prodhimit).
3. Komisioni gjatë pranimit të pasurisë jofinanciare harton procesverbal dhe në rastet e mospranimit të pasurisë jofinanciare shënon edhe arsyetimin e mospranimit.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohet Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi për formimin e Komisionit për pranimin e pasurisë jofinanciare të Komunës 1Nr.020/04-742 i datës 08.01.2025.

1Nr. 020/04-30038
Lipjan, më 18.06.2025



KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 par. 4 dhe 5 i Rregullores MF -Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore ,nenit 72A të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik (vendim i konsoliduar), neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, duke u bazuar në Kërkesën e Drejtorit të Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari 01-020/04-27823 të datës 04.06.2025, Kryetari i Komunës merr

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT AD.HOC PËR PRANIMIN E PASURISË JO FINANCIARE –FURNIZIMEVE, SHËRBIMEVE DHE PUNËVE

Neni 1

Përbërja e Komisionit

Për pranimin e pasurisë jofinanciare përkatësisht furnizimeve, shërbimeve dhe punëve,formoj Komisionin ad.hoc për projektin e serrave , sipas kontratës me numër 613-24-1157-1-2-1/C1024 ,në këtë përbërje:

1. Afrim Sadiku, Kryesues
2. Rrahim Krasniqi, anëtar
3. Shefki Sadiku, anëtar

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni në pajtim me dispozitat e Rregullores MF -Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore dhe Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik (vendim i konsoliduar) bën pranimin e pasurisë jofinanciare përkatësisht furnizimeve, shërbimeve dhe punëve për projektin e serrave, sipas kontratës me numër 613-24-1157-1-2-1/C1024 dhe gjatë pranimit ka për detyrë si vijon :

1. Të verifikojë sasinë e porositur, cilësinë, llojin dhe vlerën e pasurisë jofinanciare në përputhshmëri me kontratën për urdhërblenjen.
2. Komisioni nuk duhet të pranojë pasurinë jofinanciare e cila nuk është në përputhje me kontratën dhe urdhërblenjen (mënyra e amabalazhimit, cilësisë llojllojshmërisë, plotësisë dhe marka e prodhimit).
3. Komisioni gjatë pranimit të pasurisë jofinanciare harton procesverbal dhe në rastet e mospranimit të pasurisë jofinanciare shënon edhe arsyetimin e mospranimit.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr.020/04-27823

Lipjan, më 04.06.2025

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 par. 4 dhe 5 i Rregullores MF -Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore ,nenit 72A të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik (vendim i konsoliduar), neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR PRANIMIN E PASURISË JO FINANCIARE – FURNIZIMEVE, SHËRBIMEVE DHE PUNËVE PËR SHITËPINË E KOMUNITETIT PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA MENDORE-NGECJE NË ZHVILLIM MENDOR

Neni 1

Përbërja e Komisionit

Me këtë Vendim formohet Komisioni për pranimin e pasurisë jofinanciare përkatësisht furnizimeve, shërbimeve dhe punëve,për Shtëpinë e Komunitetit për persona me aftësi të kufizuara mendore-ngecje në zhvillim mendor për vitin 2025, në këtë përbërje:

1. Driton Ibrahim, Kryesues
2. Leona Bytyqi, anëtare
3. Zejnepe Hyseni, anëtare
4. _____menaxheri/a i kontratës

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni në pajtim me dispozitat e Rregullores MF -Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore dhe Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik (vendim i konsoliduar) bën pranimin e pasurisë jofinanciare përkatësisht furnizimeve, shërbimeve dhe punëve për Shtëpinë e Komunitetit për persona me aftësi të kufizuara mendore- ngecje në zhvillim mendor për vitin 2025 dhe gjatë pranimi ka për detyrë si vijon :

1. Të verifikojë sasinë e porositur, cilësinë, llojin dhe vlerën e pasurisë jofinanciare në përputhshmëri me kontratën për urdhërblerjen.
2. Komisioni nuk duhet të pranojë pasurinë jofinanciare e cila nuk është në përputhje me kontratën dhe urdhërblerjen (mënyra e amabalazhimit, cilësisë llojllojshmërisë, plotësisë dhe marka e prodhimit).
3. Komisioni gjatë pranimi të pasurisë jofinanciare harton procesverbal dhe në rastet e mospranimi të pasurisë jofinanciare shënon edhe arsyetimin e mospranimi.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohet Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

INr. 020/04-30042
Lipjan, më 18.06.2025

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 par. 4 dhe 5 i Rregullores MF -Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore ,nenit 72A të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik (vendim i konsoliduar), neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR PRANIMIN E PASURISË JO FINANCIARE –
FURNIZIMEVE, SHËRBIMEVE DHE PUNËVE PËR QENDREN KRYESORE E
MJEKËSISË FAMILJARE NË LIPJAN -QKMF

Neni 1

Përbërja e Komisionit

Me këtë Vendim formohet Komisioni për pranimin e pasurisë jofinanciare përkatësisht furnizimeve, shërbimeve dhe punëve,për Qendren Kryesore të Mjekësisë Familjare në Lipjan- QKMF për vitin 2025, në këtë përbërje:

1. Ragip Hasani, Kryesues
2. Alban Bytyqi, anëtare
3. _____menaxheri/a i kontratës

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni në pajtim me dispozitat e Rregullores MF -Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore dhe Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik (vendim i konsoliduar) bën pranimin e pasurisë jofinanciare përkatësisht furnizimeve, shërbimeve dhe punëve për Qendren Kryesore e Mjekësisë Familjare në Lipjan- QKMF për vitin 2025 dhe gjatë pranimit ka për detyrë si vijon :

1. Të verifikojë sasinë e porositur, cilësinë, llojin dhe vlerën e pasurisë jofinanciare në përputhshmëri me kontratën për urdhërbljerjen.
2. Komisioni nuk duhet të pranojë pasurinë jofinanciare e cila nuk është në përputhje me kontratën dhe urdhërbljerjen (mënyra e amabalazhimit, cilësisë llojllojshmërisë, plotësisë dhe marka e prodhimit).
3. Komisioni gjatë pranimit të pasurisë jofinanciare harton procesverbal dhe në rastet e mospranimit të pasurisë jofinanciare shënon edhe arsyetimin e mospranimit.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohet Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-30034
Lipjan, më 18.06.2025





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021 si dhe nenit 10 të Rregullores për transportin e rregullt urbano-periferik të udhëtarëve me autobus 15Nr.011-7239 të datës 31.01.2019, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E APLIKACIONEVE PËR NDARJEN E
RENDEVE TË UDHËTIMIT TË TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE ME AUTOBUS

Neni 1
Përbërja

Formohet Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve për ndarjen e rendeve të udhëtimit të transportit të udhëtarëve me autobus, (në vazhdim të tekstit Komisioni), sipas shpalljes publike Nr.13-011/01-26550 të datës 28.05.2025, në përbërje si vijon:

1. Behar Aliu, Kryesues
2. Rafete Retkoceri, anëtare
3. Rrahman Olluri, anëtar
4. Bujar Curri, anëtar
5. Valdete Muji, anëtare

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

1. Komisioni ka për detyrë që të shqyrtoj aplikacionet e operatorëve të transportit të udhëtarëve me autobus, të cilët kanë aplikuar sipas Shpalljes publike të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi për ndarjen e rendeve të udhëtimit brenda afatit 30 ditor nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.
2. Komisioni konform nenit 10 par. 5 të Rregullores për transportin e rregullt urbano-periferik të udhëtarëve me autobus, pas shqyrtimit të aplikacioneve, harton propozimet konkrete për ndarjen e rendeve të udhëtimit operatorëve transportues, të cilët i plotësojnë më së miri kushtet e konkursit.
3. Propozimet nga paragrafi paraprak, Komisioni ia dërgon Drejtorit të Drejtoratit për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim për miratim dhe marrjen të Vendimit.
4. Punët ndihmëse administrative dhe teknike për Komisionin do ti kryej Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohet Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.
Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet Vendimi për formimin e komisionit për shqyrtimin e aplikacioneve për ndarjen e rendeve të udhëtimit të transportit të udhëtarëve me autobus 1Nr.020/01-26763 i datës 13.06.2025

1Nr. 020/01-26763/2
Lipjan, më 16.06.2025



KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF -NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe nenve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve –, që kanë aplikuar sipas thirrjes publike “Mërgata Fest dhe Sports 2025” Nr.5-453/01-24005 të datës 13.05.2025, në përbërje si vijon:

1. Ramiz Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesues
2. Trimor Shamolli, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Shehide Sopa-Ibrahimi, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Erdona Kadriolli nga OJQ-të anëtare
5. Euresa Karpuzi, në cilësinë e ekspertes të jashtëme, anëtare
6. Pranvera Krasniqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtare rezervë

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve që kanë aplikuar sipas thirrjes publike „Mërgata Fest dhe Sports 2025” Nr.5-453/01-24005 të datës 13.05.2025 ,të shpallur nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport. Komisioni do t’i kryejë detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kulturë Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.
Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi për formimin e komisionit vlerësues 1Nr.020/04-30036 i datës 18.06.2025.

1Nr.020/04-30036/2
Lipjan, më 18.06.2025

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021 duke u bazuar edhe në Kërkesën e Drejtorit të Drejtoratit për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dërguar me email zyrtar me datë 20.05.2025, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim formohet Komisioni për identifikimin e ndërtesave me material azbesti, në përbërje si vijon:

1. Jetmir Bytyqi, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Kryesues
2. Avni Sahiti, Drejtorati për Inspeksion, anëtar
3. Sazana Demiri Rexhepi, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtare

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

1. Komisioni ka për detyrë që të bëjë identifikimin e ndërtesave me material azbesti në territorin e Komunës së Lipjanit dhe lidhur këtë të hartoj Raport me të cilin duhet ta njoftoj Kryetarin e Komunës dhe Drejtoratin për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit më së largu me datë 30.06.2025.
4. Punët ndihmëse administrative dhe teknike për Komisionin do ti kryej Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe me të njëjtin të njoftohet Drejtori i Drejtoratit për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-27771
Lipjan, më 04.06.2025

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400/01-16372 të datës 31.03.2023 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **9,800.00€**, (nëntë mijë e tetëqindë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-27353 e datës 02.06.2025, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 35 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin maj të vitit 2025 me nga 280 euro për secilin rast $35 \times 280 = 9,800.00€$, të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2025, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB.

Neni 3

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame i Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/01-27353
Lipjan, më 03.06.2025

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Rregullores (QRK)- NR. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme, udhëzuesit për zbatimine Rregullores, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM

PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARIT TË KOMISIONIT KOMUNAL PËR KTHIM

I. Me këtë Vendim, zëvendësohet, anëtari i Komisionit komunal për kthim në numrin rendor katër (4) Lorik Bërbatovci nga QPS i caktuar, sipas Vendimit të Kryetarit të Komunës për themelimin e Komisionit komunal për kthim 1Nr.020/04-16922/2 i datës 08.04.2022, për shkak të transferimit në Drejtoratin tjetër dhe në vend të tij caktohet:

ZYRAFETE MAVRIQI-BYTYQI, nga Qendra për Punë Sociale -Lipjan.

II. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit komunal për kthim janë të përcaktuara me dispozitat e Vendimit të Kryetarit të Komunës për themelimin e Komisionit komunal për kthim 1Nr.020/04-16922/2 i datës 08.04.2022.

III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

Zoran Stojamovic ZLK, Kyesues i Komisionit
Zyrafete Mavriqi-Bytyqi

1Nr. 020/04-16922/3

Lipjan, 23.06.2025

KRYETARI I KOMUNËS





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve –, që kanë aplikuar sipas thirrjes publike “Rinia Fest Lipjan 2025” Nr.5-453/01-28236 të datës 05.06.2025, në përbërje si vijon:

1. Pranvera Krasniqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesuese
2. Ramiz Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Albulena Salihu, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Valmira Marevci, nga OJQ-të, anëtare
5. Fatbardha Drnogllava, në cilësinë e ekspertit të jashtëm, anëtare dhe
6. Uran Qeriqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar rezervë

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve që kanë aplikuar sipas thirrjes publike “Rinia Fest Lipjan 2025” Nr.5-453/01-28236 të datës 05.06.2025 të shpallur nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport. Komisioni do t'i kryejë detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kulturë Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/01-32030

Lipjan, më 27.06.2025

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

